



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Prishti - Pristina, Međana 29.12.2015

No. i organit	NUMERI I	Titulli	Vlera
02013/194		Prilog	Vrednos



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazetës Zyrtare nr. 28/2008 dhe nenit 36.2 shkronja d) së Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr. 013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 24.12.2015, aprovon këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E BUSTIT TË DËSHMORIT HOXHË JONUZ ZEJNULLAHU NË ZONËN KADASTRALE NË GJYLEKAR

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, CAKTON lokacion për vendosjen e bustit të Dëshmorit Hoxhë Jonuz Zejnullahu në fshatin Gjylekar në zonën kadastrale Gjylekar të Komunës së Vitisë.

Neni 2

Vendi- lokacioni për vendosjen e bustit të Dëshmorit Hoxhë Jonuz Zejnullahu caktohet në parcelën me nr.1905-2 në sipërfaqe të përgjithshme prej 185 m² në Zonën Kadastrale – Gjylekar e cila është në pronësi të Komunës së Vitisë sipas të dhënave të ofruara nga Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 3

Parcela kadastrale e lartshënuar, që është objekt i këtij vendimi propozohet të jetë vetëm për destinacionin e përcaktuar në nenin 1 të këtij vendimi dhe nuk mund të shfrytëzohet për qëllime tjera.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Vitisë.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. MAPL-së
2. DKPGJ-së,
3. DUPMM, dhe
4. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

